VENDIM
Nr. 42, datë 23.1.2013

PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE PËR KËSHILLIN KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVIZIONIT, PËR VITIN 2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT), për vitin 2013, për shumën 108 100 000 (njëqind e tetë milionë e njëqind mijë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha